



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË
BORDI

VENDIM

Nr.129, Datë 24.06.2025

MBI

PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS ADMINISTRATIVE TË NISUR ME VENDIMIN E BORDIT TË ERE-S NR. 87, DATË 24.04.2025 “MBI FILLIMIN E PROCEDURËS PËR HEQJEN E LICENCËS NR. 129, SERIA PV11K NË VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE, DHËNË SHOQËRISË “SELISHTË” SH.P.K.”

Në mbështetje të nenit 16 të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike”, i ndryshuar; neneve 95 dhe 113 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”; neneve 7, 8 dhe 9 të Rregullores për procedurat e heqjes së licencave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror, miratuar me vendimin e bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 58, datë 18.04.2017; si dhe nenit 15 të Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurave të ERE-s, miratuar me vendimin e bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 24.06.2025, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 1246/4 prot., datë 19.06.2025, të grupit të punës “Mbi përfundimin e procedurës administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.04.2025 “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SELISHTË” sh.p.k.”

Konstatohet se:

- Bordi i ERE-s, me vendimin nr. 87, data 24.04.2025, vendosi fillimin e procedurës për heqjen e licencës Nr. 129, Seria PV11K, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SELISHTË” sh.p.k., për arsye të mosshlyerjes në afat të pagesës rregullatore për vitin 2024, si dhe të mosdepozitimit të ndonjë dokumenti apo sqarimi lidhur me këtë mospërbushje..
- Me shkresën nr. 1335/1 prot., datë 30.04.2025, shoqëria është njoftuar për vendimin e bordit të ERE-s nr. 87/2025, duke i bërë me dije se ka të drejtën për t’u përgjigjur me shkrim brenda 30 ditëve nga data e marrjes së këtij njoftimi. Një kopje e skanuar e kësaj shkrese i është dërguar shoqërisë dhe me postë elektrike në adresën e saj të e-mailit.
- Vendimi i bordit të ERE-s nr. 87, data 24.04.2025, është publikuar në Fletoren Zyrtare nr. 89, datë, 26.05.2025, ndaj dhe afati 30-ditor vlerësohet të fillojë nga kjo datë.

- Pasi nga shoqëria nuk rezultoi të ishte kryer pagesa apo depozituar përgjigje pas vendimit të bordit, u realizua një komunikim telefonik, gjatë të cilit përfaqësuesi konfirmoi marrjen e njoftimit dhe njohjen e detyrimit, duke sqaruar se për shkak të vështirësive financiare pagesa nuk është kryer në afat. Subjekti u angazhua për përmbushjen e detyrimit, ndërsa ERE bëri me dije se pagesa duhet të realizohet brenda afatit të përcaktuar.
- Nga rakordimet/verifikimet në gjendjen e llogarisë bankare (statement) të ERE-s rezulton shoqëria e ka shlyer plotësisht debinë e saj në datën 03.06.2025, brenda afatit 30-ditor të publikimit në Fletoren Zyrtare të vendimit të bordit të ERE-s nr. 87/2025, për fillimin e procedurës për heqjen e licencës së shoqërisë.
- Në nenin 9, gërma “a” të “Rregullores për procedurat e heqjes së licensave në sektorin e energjisë elektrike dhe të gazit natyror”, parashikohet se, *Me marrjen e informacionit të detajuar me të dhënat sipas nenit 7 dhe 8 të kësaj rregulloreje, Bordi do të vendosë për mbylljen e procedurës për heqjen e licencës.*
- Në nenin 95 të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, parashikohet se: *Organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.*
- Qëllimi i procedurës administrative, në kuptim të kësaj dispozite, është bërë i pamundur për shkak të ndryshimit të rrethanave të faktik, konkretisht shlyerjes së plotë të detyrimit financiar nga ana e shoqërisë “SELISHTE” sh.p.k. Vërtetimi i pagesës së prapambetur konfirmon se janë zhdukur kushtet që çuan në nisjen e procedurës për heqjen e licencës, pasi objekti për të cilin është nisur kjo procedurë nuk ekziston më. Në këto kushte, vlerësohet përfundimi i procedurës për heqjen e licencës dhe shfuqizimi i vendimit të bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.04.2025..
- Në nenin 113 të “Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” është parashikuar mundësia e shfuqizimit të plotë apo të pjesshëm të një akti, me nismën e vetë organit që e ka nxjerrë, duke përcaktuar dhe formën ligjore të këtij ndryshimi të aktit, e cila duhet të bëhet me një akt të ri me shkrim.

Për gjithë sa më sipër, bordi i ERE-s,

Vendosi:

1. Të përfundojë procedurën administrative të nisur me vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.04.2025, “Mbi fillimin e procedurës për heqjen e licencës nr. 129, seria PV11K në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike, dhënë shoqërisë “SELISHTE” sh.p.k.”.
2. Të shfuqizojë vendimin e bordit të ERE-s nr. 87, datë 24.04.2025.
3. Grupi i punës të njoftojë shoqërinë për vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t’i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara. Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI

Petrit AHMETI